



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Rektoratin e Universitetit “Aleksander Xhuvani” shpall konkurs për pozicionin e punës 1 (një) personel ndihmësakademik me karakter administrativ, me kohë të plotë, specialist IT në Sektorin e IT-së,

Specialisti i Sektorit të IT-së përgjigjet për:

- Është nëpunës i nivelit ekzekutiv; mban përgjegjësi për mbarëvajtjen e burimeve informatike dhe infrastrukturës, duke përfshirë sistemet e shkëmbimit të informacionit, rrjetin kompjuterik hardware (pajisjet kompjuterike) dhe software (programet) si dhe mjetet e tjera të komunikimit në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- përgjigjet për zgjidhjen ligjore dhe teknike të problemeve të sektorit të IT në përputhje me përshkrimin e punës. Bashkëpunon me specialistët e sektorit si dhe strukturat brenda dhe jashtë drejtorisë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Në rast mosmarrëveshjes me struktura të tjera UE-së, njofton përgjegjësin e sektorit ose drejtorin i cili ndjek zgjidhjen e konfliktit. Punon për realizimin e detyrave të ngarkuara nga aktet nën ligjore ose nga eprorët brenda afatit dhe raportimin e tyre. Kryen me përpikmëri në nivel profesional të gjitha detyrat e ngarkuara.

Kriteret e përgjithshme:

- të zotërojë diplomë të ciklit (nivelit) të dytë të studimeve Master, në fushën e teknologjisë së informacionit.
- të ketë përvojë pune.
- të ketë njohuri të paktën e një gjuhe të huaj të vertëtuuar me dokumentacion.
- të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- të jetë i aftë për punë.

Kriteret e veçanta:

- Të ketë kryer trajnime apo kualifikime në fushën përkatëse
- Referenca pune nga punëdhënësit;
- Të kenë aftësi të mira komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkiv të Rektoratit të Universitetit të Elbasanit “Aleksander Xhuvani” brenda



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

10 (dhjetë) ditëve (**07.03.2022 - 16.03.2022**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Letër motivimi për pozicionin e punës specialist i Sektorit të IT-së në Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (**07.03.2022 - 16.03.2022**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *specialist i Sektorit të IT*
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e **Rektoratit**. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (18.03.2022 – 31.03.2022). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORI